



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2018, ora 12.30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë për zbatimin e ligjit nr.10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Elona Hoxha, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Spartak Braho dhe Antoneta Dhima.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë

Edis Ibrahim – këshilltar i ministres së Drejtësisë

Aurel Lamçe – Drejtori i Përgjithshëm i Ekonomisë dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Engjëll Hysi – Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar, përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës

Kasem Berberi – prokuror në Prokurorinë e Tiranës

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare. Siç janë njoftuar edhe kolegët, sot në rendin e ditës të mbledhjes së këtij komisioni kemi parashikuar të kemi një seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë, zonjën Etilda Gjonaj. Kjo seancë dëgjimore lidhet me monitorimin e zbatimit të ligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet liria e lëvizjes me vendim gjyqësor. Nuk është një ligj i ri, sepse është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2011, ndërsa fillimi i zbatimit efektiv daton në vitin 2013. Duke konsideruar që mbikëqyrja elektronike është një masë e rëndësishme, që ndihmon në zbatimin sa më efektiv të dënimeve penale, por jo vetëm, sepse këtu flasim për disa kategori vendimesh gjyqësore që përmbajnë dënime penale, dënime plotësuese, masa sigurie, urdhër mbrojtje ose një nga alternativat e dënimit me burgim, kuptohet që edhe interesi për ecurinë e zbatimit të këtij ligji është i madh. Pra, është një masë që ka efekt të drejtpërdrejtë në sigurinë publike, por është edhe një mënyrë për të kuptuar se cila është qasja jonë ndaj zbatimit të teknologjisë.

Për më tepër dua të prezantoj të ftuarit dhe t'u linim atyre fjalën të parëve dhe pastaj të hapim diskutimin në komision. Pra, me ne kemi ministren e Drejtësisë zonjën Gjonaj.

Faleminderit, zonja Gjonaj, për prezencën tuaj!

Më duhet të them që zonja Gjonaj ka qenë e gatshme për ta pasur këtë seancë dëgjimore edhe më parë, por agjendat e ndryshme na kanë obliguar që takimin ta bënim sot. Po kështu kemi të ftuar zotin Engjëll Hysi, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar, përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës. Faleminderit, zoti Hysi, për prezencë tuaj! Kemi zotin Kasem Berberi, prokuror në Prokurorinë e Tiranës, i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale, që besoj se do të na japë një kontribut të çmuar gjatë seancës së sotme dëgjimore. Faleminderit, zoti Berberi, për prezencën tuaj në Komisionin e Sigurisë! Kemi dhe dy këshilltarë të ministres së Drejtësisë, zotin Gentian Deva dhe zotin Edis Ibrahim. Faleminderit!

Më lejoni që fjalën t'ia kaloj zonjës Gjonaj, për një prezantim lidhur me zbatimin aktual të ligjit për mbikëqyrjen elektronike.

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – E nderuara zonja kryetare, ju falënderoj për ftesën në komision.

Mbikëqyrja elektronike është një çështje shumë e rëndësishme, pasi është një ndër elementet që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve penale dhe është një ndër risitë që u fut

në sistem për sa u përket dënimeve alternative apo masave të sigurisë në mënyrë alternative. Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave të vitit 2012, mbikëqyrja elektronike e përcaktuar nga kjo VKM realizohet nga Shërbimi i Provës dhe po sipas pikës 3 të këtij vendimi, Ministria e Drejtësisë, për realizimin e mbikëqyrjes elektronike, kontraktin në përputhje me dispozitat e ligjit për prokurimin publik, nëpërmjet procedurës së hapur, shërbimet e një subjekti që ka eksperiencën e nevojshme në fushën e mbikëqyrjes elektronike.

Do të më lejoni të paraqes një historik të shkurtër se çfarë ka ndodhur me mbikëqyrjen elektronike për sa u përket procedurave të prokurimit publik, më pas do të ndalem në disa nga problemet apo çështjet teknike që ka sot mbikëqyrja elektronike dhe vështirësitë që ne po hasim, të cilat, gjithashtu, do të prezantohen edhe nga drejtori, por edhe masat që kemi marrë ne si ministri në bashkëpunim me Shërbimin e Provës për të përmirësuar shërbimin dhe për të rregulluar ato problematika që kemi evidentuar deri tani, por njëkohësisht dhe për të vënë përpara përgjegjësisë ato nëpunës, të cilët kanë shkelur procedurat apo rregullat dhe ne sot jemi përpara disa problematikave.

Përpara se të filloj diskutimin tim, megjithëse nuk do të ndalem në problemet teknike të sistemit të byzylykëve, por në momentin që drejtori i përgjithshëm zoti Hysi do të flasë, për shkak të elementeve të sigurisë, të mos lejohen kamerat gjatë diskutimi të këtyre problematikave teknike. Gjithsesi, kjo ngelet në vlerësimin tuaj.

Ermonela Felaj – Të vijomë me prezantimin e parë dhe në momentin e duhur vendosim së bashku me komisionin.

Etilda Gjonaj – Siç e theksova, po ndalem në historikun e procedurave të prokurimit publik lidhur me mbikëqyrjen elektronike, e cila ka filluar në prill të vitit 2013. Për vitin 2012 në Ministrinë e Drejtësisë ka pasur një fond të konsiderueshëm, të vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit, për procedurën me objekt: “Mbikëqyrjen elektronike në fushën penale”, me vlerë rreth 35 milionë lekë. Nga procedurat finale në vitin 2012 është nënshkruar një kontratë me shoqërinë “GPS Global” me shumën e përafërt prej 33 milionë lekësh. Mbas 2 vjetësh, në dhjetor të vitit 2014 është lidhur kontrata e dytë, me objekt: “Shërbim dhe mirëmbajtje të sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale”, me vlerë 68 milionë. Kompania në të dyja rastet, pavarësisht se janë kompani të ndryshme, ka pasur si detyrë realizimin e shërbimit, mirëmbajtjen e sistemit në tërësi dhe në rastet kur ka probleme me performancën e sistemit, operimin e sistemit dhe funksionalitetin e sistemit. Mbas dy vjetëve, në datën 21.02.2017 lidhet një kontratë tjetër nga Ministria e Drejtësisë, përsëri për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale, me bashkimin e operatorëve ekonomikë “Fast Tek sh.p.k.”, “Soft Solution” dhe “Ratec sh.p.k.” me vlerën 233 milionë lekë. Kjo kontratë ka një kohëzgjatje 4-

vjeçare, që do të thotë se e shtrin efektin e saj deri në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar një sërë problemesh për sa i përket mbikëqyrjes elektronike, pasi ka pasur keqfunksionim të pajisjeve të gjurmimit apo të byzylykëve, që garantonin mbikëqyrjen nga salla operative e Shërbimit të Provës. Drejtoria e Mbikëqyrjes Elektronike ka njoftuar në rrugë elektronike prokuroritë dhe gjykatat se Drejtoria e Përgjithshme e Provës nuk mund të pranojë urdhrat e ekzekutimit, të cilat parashikojnë masën e sigurisë arrest në shtëpi me mbikëqyrje elektronike. Kjo me qëllim që gjykatat të mos japin më vendime me mbikëqyrje elektronike dhe prokuroritë të mos i kërkojnë ato, për shkak të këtyre problematikave teknike. Ky është një shqetësim i ngritur në datën 10.08.2017, kur ishte si ministër teknik zoti Bardhi. Më pas Shërbimi i Provës dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes Elektronike, duke u gjendur përpara vështirësive dhe defekteve që kishin filluar me zbatimin e kontratës së re, të cilën e përmenda, u morën edhe me një sërë masash të tjera, duke njoftuar drejtoritë rajonale të Policisë së Shteti për marrjen në mbikëqyrje të të gjitha subjekteve si pasojë e këtyre problemeve teknike të shfaqura. Aktualisht në këtë moment Shërbimi i Provës vazhdon në mënyrë periodike të njoftojë gjykatat për pamundësinë e aplikimit të mbikëqyrjes elektronike.

Nga ana jonë si Ministri e Drejtësisë dhe nga Shërbimi i Provës janë marrë disa masa në disa drejtime: së pari, për të vënë përpara drejtësisë përgjegjësit e këtyre problematikave, të cilat lidhen me kontratën e mbikëqyrjes elektronike, dhe, së dyti, për të marrë masat administrative se si mund të përmirësohet ky shërbim, pavarësisht se kemi një kontratë të çimentuar me kushtet që ofrohen që në shkurt të vitit 2017.

Ministri i Drejtësisë së asaj kohe urdhëroi hetimin administrativ për veprimet në lidhje me kontratën, “Për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” në shkurt të vitit 2017, me bashkimin e tri kompanive që përmenda më lart dhe pas hetimit administrativ grupi i punës arriti në disa konkluzione, gjë që bëri që ministri i Drejtësisë në atë kohë të depozitonte një kallëzim penal në Prokurorinë e Tiranës.

Kallëzimi penal lidhej me shpërdorimin e detyrës nga sekretarja e përgjithshme dhe gjithë zinxhiri i nëpunësve, të cilët kishin qenë pjesë e lidhjes së kontratës apo marrjes në dorëzim të sistemeve.

Mbi bazën e këtij informacioni, prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistroi kallëzimin penal, por, në fakt, u vendos mosfillimi i procedimit penal për këtë kallëzim. Për këtë arsye, në kohën kur unë isha në pozicionin e ministres së Drejtësisë, ndoqëm gjithë rrugën ligjore për kundërshtimin e vendimit të prokurorisë dhe më pas në gjykatë. Gjykata vendosi që ky vendim i prokurorisë të rishikohej dhe të rifillonin hetimet.

Pas herës së dytë të kthimit të kësaj çështjeje në Prokurorinë e Tiranës, pas kryerjes së hetimeve, u vendos pushimi i çështjes për sa i përket kallëzimit të kryer në atë kohë nga ministri Bardhi.

Aktualisht, çështja ka shkuar edhe në Gjykatën e Apelit, e cila, gjithashtu, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku sot kemi pushimin e këtij kallëzimi të kryer në korrik dhe gusht të vitit 2017.

Për shkak se sistemi dhe problematikat në sistem vazhdojnë, vazhdonin edhe në vitin 2017, pjesën e dytë të vitit 2017 edhe gjatë vitit 2018, nga ana ime u nxorën një sërë urdhrash të brendshëm për të kryer hetim administrativ lidhur me përgjegjësitë e të gjithë atyre, që kishin qenë pjesë e lidhjes së kontratës, duke përfshirë edhe përgjegjësit e kompanisë dhe pas hetimit administrativ rezultuan një sërë shkeljesh, të cilat kishin të bënin me mënyrën e prokurimit publik.

Meqenëse hetimi administrativ nuk mund t'i shkojë dot deri në fund këtij aspekti, më pas u vendos Drejtoria e Auditit, e cila kreu një auditim, një kontroll të thelluar për të gjithë procedurën e kontraktuar për mbikëqyrjen elektronike për kontratën e shkurtit 2017. Auditit, së fundmi, ka nxjerrë rezultatet e tij, por për shkak se disa veprime janë në kufijtë e veprës penale, sipas ligjit është njoftuar inspektimi financiar në Ministrinë e Financave, të cilët aktualit, po përfundojnë kontrollin e thelluar lidhur me këtë raport të Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

Menjëherë sapo të kemi rezultatet e inspektimit financiar, do t'jua bëjmë me dije juve si një komision, që keni objekt shqyrtimin dhe diskutimin të çështjeve dhe elementet e sigurisë.

Në aspektin administrativ, për të përmirësuar shërbimin, po punojmë me një kontratë tashmë të çimentuar për të cilën nuk do të kishte asnjë vlerë prishja e saj, sepse janë kushtet e kontratës të tilla, të cilat nuk na lejojnë dhe nuk na mundësojnë të bëjmë këtë gjë. Tani që ka mbetur vetëm pjesa e mirëmbajtjes do të ishte për ne humbje në vlera financiare nëse do të bënim prishje të menjëhershme të kontratës. Kjo është arsyeja që kemi pritur dhe po presim edhe përfundimet e inspektimit financiar me qëllim që të vendosim se çfarë do të bëjmë me kompaninë.

Deri tani jemi munduar të përmirësojmë elemente të caktuara, rast për rast, që na kanë rezultuar nga mbikëqyrja elektronike si problematika, së bashku me kompaninë, së bashku me një grup të përbashkët pune në Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin e provës, me qëllim që të mos kemi problematika të largimit të personave që janë nën mbikëqyrjen elektronike.

Aktualisht, në sistem janë vetëm 9 persona me mbikëqyrje elektronike. Ka një shqetësim real edhe nga gjykatat. Ka një shqetësim real edhe nga ana ime për shkak se nuk po

zbatohet dot detyrimet e ligjit për mbikëqyrjen elektronike. Kjo do të na mundësonte, së pari, uljen e mbipopullimit në institucionet penitenciare dhe, së dyti, aplikimin dhe zbatimin e ligjit, i cili është ngritur pikërisht për këtë qëllim.

Për çështjet teknike do t'ia kaloj fjalën zotit Hysi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Unë besoj se mund të kemi disa pyetje në raport me ato u shprehën nga ana juaj.

Po e bëj unë pyetjen e parë. Ju thatë se janë dhënë disa herë lekë nga buxheti i shtetit për të vënë në funksionim byzylykët elektronikë. Herën e parë janë dhënë 35 milionë lekë, herën e dytë në vitin 2014 janë dhënë 68 milionë lekë dhe në vitin 2017 është dhënë një shifër shumë më e lartë, 233 milionë lekë (gjithmonë flasim me lekë të reja).

Dua të di, me këto lekë që janë dhënë, sa byzylykë elektronikë janë vënë në dispozicion?

Sa prej tyre paraqiten në gjendje pune? Ju iu referuat një shifre kur përmendët se ka 9 persona aktualisht nën mbikëqyrje elektronike, po kam parasysh se këto lekë janë dhënë edhe më herët, e ndarë në vite nga vitin 2013 deri më sot, sa herë janë përdorur? Çfarë problematikash ka pasur që kontratën e bëjnë të pamundur për t'u zbatuar në ato nivele që, të paktën, pretendohen nga ligji? Ne në fakt, do të dëshironim shumë që sot, pas 8 vjetësh, të mund ta shtrinim mbikëqyrjen elektronike edhe për pjesën e të dënuarve që janë në përfundim të dënimit me burgim si një masë e cila do të ndikonte drejtpërsëdrejti edhe në një problematikë që nuk e hasim vetëm ne në Shqipëri, por e hasin të gjitha vendet e zhvilluara, që ka të bëjë me mbipopullimin e burgjeve.

Çështja e mbipopullimit të burgjeve nuk është thjesht një çështje faktike e një sipërfaqeje të populluar nga më shumë njerëz se sa duhet normalisht, por është edhe një çështje financiare për shtetin dhe ndoshta do të na duhet të bënim një llogari shumë të mirë, nëse na intereson t'i referohemi teknologjisë, duke u siguruar se kemi teknologjinë më të mirë apo duhet të investojmë në drejtim të ndërtimit të burgjeve të reja dhe pajisjes së tyre me kapacitete njerëzore.

Besoj se pjesa e asaj reforme të rëndësishme që Ministria e Drejtësisë ka shpallur, reformën penitenciare (ma do mendja se ministria ndan të njëjtin mendim me mua), të ishte edhe pjesa që ka të bëjë me mbikëqyrjen elektronike.

Sidoqoftë, do të më interesonte të kishim një të dhënë për këtë çështje, pra çfarë është bërë me secilën prej shumës së të hollave që janë dhënë për të vënë në zbatim mbikëqyrjen elektronike.

Etilda Gjonaj – Ju falënderoj, zonja kryetare për pyetjen dhe për komentin!

Në fakt, ashtu siç edhe ju e përmendët, ne kemi ndërmarrë një reformë të thellë në sistemin penitenciar dhe pa dashur që ta marr kohën në këtë seancë dëgjimore, që në fakt ka një fokus tjetër theksoj se reforma në sistemin penitenciar ka si pjesë të saj edhe reformimin e kuadrit ligjor dhe pavarësisht se mbikëqyrja elektronike, shërbimi i provës, nuk është pjesë e sistemit penitenciar, duke i parë si institucione ligjzbatuese, ekzekutuese të vendimeve gjyqësore penale, janë përfshirë në paketën që ne po rishikojmë. Është pikërisht edhe ligji “Për shërbimin e provës”, pasi deri tani nuk ka pasur një të tillë, njëkohësisht edhe rishikimi i ligjit “Për mbikëqyrjen elektronike”, por edhe pjesa e paketës së sistemit penitenciar, si ligji “Për trajtimin e të dënuarve”, “Për policinë e burgjeve”, “Për SHKBB-në” apo edhe ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Pra, është një paketë tërësore që përfshin të gjitha organet ligjzbatuese për ekzekutimin e vendimeve penale.

Ajo çfarë ju evidentuat me të drejtë, që në fakt është një shqetësim, ku me kalimin e viteve buxheti është katërfishuar për sa i përket mbikëqyrjes elektronike, që në fakt, këto kontrata edhe në emërtim kanë pasur si objekt përmirësimin e sistemit për mbikëqyrjen elektronike, ka rezultuar që, edhe në vitin 2014, edhe në vitin 2017 procedura ka filluar nga zero, pra ka filluar gjithçka nga fillimi, që do të thotë se janë blerë pajisje të reja dhe gjithmonë bëhet fjalë për një numër total, 300 byzylykë, të cilët shërbejnë për zbatimin e masave për mbikëqyrjen elektronike të vendosur nga gjykata.

Numri më i lartë që ne kemi pasur nën mbikëqyrje elektronike me byzylykë ka qenë 93 në këtë periudhë. Ndërkohë, është vetëm 9 numri aktual për shkak të faktit se Drejtoria e Shërbimit të Provës ka lajmëruar gjykatat për një problematikë që është evidentuar në sistem dhe me qëllim që të mos kemi problematika të largimit të personave që janë mbikëqyrje elektronike, kemi marrë këto masa shtesë që të mos kemi këto lloj problemesh.

Ajo çka rezulton vetëm në kontratën e fundit që i është nënshtruar, siç e thashë, një hetimi administrativ të mëparshëm nga ministri i mëparshëm i Drejtësisë, nga unë, sapo mora detyrën, nga Auditi i Brendshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe tashmë të gjitha gjetjet e auditit janë pjesë e inspektimit financiar të drejtorisë së inspektimit në Ministrinë e Financave, që do të thotë se ka pasur një sërë problemesh që vijnë që nga mënyra e konceptimit dhe ideimit që shërbimi do të ofrojë me pajisje të reja, pavarësisht se numri mbetet po i njëjtë, pasi ka qenë një vlerësim që është bërë në mënyrë të vazhdueshme. Numri maksimal që mund të jepet për masat me mbikëqyrje elektronike nuk kanë qenë më shumë se 300 dhe kjo ka qenë arsyeja se pse në kontratë është vendosur gjithmonë numri 300.

Ajo çka rezulton dhe që unë bashkë me stafin ekzekutues të kësaj kontrate jemi në vështirësi është se nuk bëjmë dot asnjë lloj lëvizjeje të kontratës prej 233 milionësh dhe nuk bëjmë dot as përmirësime reale të këtyre pajisjeve që ndodhen në Ministrinë e Drejtësisë.

Na rezulton që rreth 105 pajisje, byzylykë, janë në gjendje pune, por që janë ende të pakolauduara dhe për këtë arsye është ngritur grupi i përbashkët i punës duke përfshirë AKSH-in, Shërbimin e Provës dhe përfaqësues nga kompania, me qëllim që të gjejmë çka mund të përmirësojmë me këto pajisje që kemi, deri sa të gjejmë një zgjidhje ligjore për rishikimin e kontratës me kompaninë apo edhe vënien para përgjegjësisë të subjekteve që kanë lidhur këtë kontratë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Urdhëroni, zoti Braho!

Spartak Braho – Kemi parë vendimin e pushimit të kësaj çështjeje të denoncuar në prokurori. Për çfarë bën fjalë arsyetimi i pushimit, nëse ju kujtohet?

E dyta, ka bërë mirë drejtori i Shërbimit të Provës që s'i ka përdorur dhe kjo është një çështje e denoncuar nga media, sepse ata që kanë qenë para jush nuk kanë marrë byzylykë për të siguruar të dënuarit, por kanë marrë byzylykë për bagëti. Kjo është çështja dhe thuajeni troç këtë muhabet.

Ermonela Felaj – Urdhëroni!

Etilda Gjona – Në rastin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal është vendosur mosfillimi me arsyetimin se në analizë, për sa është kallëzuar, nuk rezulton që veprimet e shtetases, në atë kohë sekretare e përgjithshme, të jenë kryer me dashje për të sjellë si pasojë cenimin e funksionimit normal të punës për mbikëqyrjen elektronike. Kontrata si element thelbësor i funksionimit të marrëveshjes midis palëve ka rregulluar mënyrat e sjelljes në rast të mospërmbylljes së detyrimeve të ndërsjella dhe sa më sipër fakti nuk parashikohet nga ligji si vetëm penale.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë jam dakord me ju dhe kjo është arsyeja që i është nënshtruar si procedurë një sërë hetimeve administrative, auditeve të brendshme, inspektimit financiar, të shikojmë rezultatet e raportit të inspektimit financiar dhe pastaj të dalim në konkluzionin se cila është problematika dhe cilët janë përgjegjësit që kanë lidhur këtë kontratë.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Vorpsi!

Sadi Vorpsi - Faleminderit!

Kjo shumë a është ezauruar tashmë? A është lëvruar komplet kontrata? A është marrë në dorëzim?

Etilda Gjonaj – Kjo është vështirësia, zoti Vorpsi, sepse pothuajse është ezauruar pjesa më e madhe e buxhetit të përcaktuar edhe në kontratë me kompanitë për këtë shërbim dhe ezauruar që në fillimet e saj. Është ezauruar 64% e vlerës së kontratës deri në fund të vitit 2017 dhe pjesa e mbetur ka të bëjë vetëm me shërbimin e mirëmbajtjes, jo më të një sistemi të ri apo përmirësimit të sistemit, ashtu siç ka qenë shërbimi i parë për t'u ofruar nga kompania dhe që është ofruar që në fillim të vitit 2017, menjëherë me lidhjen e kontratës.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Duzha!

Luan Duzha - Faleminderit!

Doja më shumë të sqarohesha. Ju keni blerë shërbimin apo keni blerë mallin në këto tri kontratat që janë lidhur?

Nëse janë blerë mallra, në këto tri kontrata a ka diferencë çmimi?

Ju thatë se kontrata e tretë është e çimentuar. Nëse malli nuk vjen tamam apo nuk është funksional, si ka mundësi të mos priset kontrata?

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Jam dakord me ju që kontrata mund të priset, por duhet parë vlerësimi i fundit që do të dalë nga raporti i auditit dhe inspektimit financiar për të kuptuar se cila është përgjegjësia e firmës dhe cila është përgjegjësia e atyre që kanë përfaqësuar shtetin në atë kohë, që kanë lidhur kontratën.

Sot na rezulton se kushtet e kontratës janë të tilla që firma thotë se unë i kam respektuar ose rezulton se i ka respektuar të gjitha kushtet në kontratë, specifikimet teknike etj.

Tek të tria kontratat janë të blera edhe shërbimet, edhe mallrat. Shërbimi është për vendosjen në funksion të pajisjeve, byzylykëve dhe njëkohësisht mallra janë pajisjet, byzylykët.

Të paktën, në dy kontratat e fundit numri total i pajisjeve është 300, që do të thotë se të tria kontratat shërbimi dhe pajisjet pothuajse janë të njëjta. Ne në fund kemi kërkuar ose presupozohet se ky ka qenë qëllimi, pavarësisht se çfarë është kërkuar që të mbikëqyren në mënyrë elektronike 300 persona të cilët janë vendosur me këtë lloj mase me vendim gjykate.

Ky është shërbimi final që kërkohet në fund, pra që ne të kemi 300 subjekte me masë nga gjykata për t'u mbikëqyruar elektronikisht dhe të tria kontratat kanë pasur të njëjtin qëllim, shërbimin dhe pajisjen, pavarësisht vlerave të tyre të ndryshme.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – E kuptoj se ka një kontradiktë, akordohen shuma të ndryshme dhe blihet i njëjti set. Ku ka qenë ndryshimi? Janë rritur kushtet në kontratë? Janë marrë byzylykë të një cilësie më të lartë, që kemi të njëjtin numër edhe pse vlera e kontratës ka ndryshuar?

Etilda Gjonaj – Duke mos e kuptuar edhe ne këtë gjë, pasi jemi konsultuar edhe me ekspertët e AKSH-it e të tjerë, kjo është arsyeja pse është bërë objekt i hetimit disa herë për të kuptuar ku qëndron problemi dhe ku qëndron veçoria e kësaj kontrate.

Ermonela Felaj – Sidoqoftë, me ato që ju keni parë, a kanë ndryshuar kushtet në kontratë? Si kanë ardhur specifikimet teknike, duke u rritur, duke e shtuar peshën e rëndësisë së tyre apo duke u zvogëluar?

Etilda Gjonaj – Ajo çka rezulton nga kontrata dhe nga specifikimet teknike, numri është i njëjtë, pra, në fund të fundit janë 300 pajisje, i bie që janë të njëjtat specifikime. E vetmja veçori që na rezulton e qartë nga kontrata e fundit është që mirëmbajtja nuk është më për 2 vjet, siç kanë qenë në kontratat e mëparshme, por është për 4 vjet, gjë që përsëri, në një vlerësim të përgjithshëm që ka bërë edhe grupi i punës, nuk përmbush pikërisht atë vlerë të lartë financiare.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Xhindi!

Anduel Xhindi - Faleminderit!

Së pari, një nga kushtet e përcaktuara në ligj për byzylykët elektronikë është tejet i vështirë për t'u hequr. A ka mundësi që punonjësi që e vendos byzylykun ta lerë enkas të lirë në mënyrë që të hiqet dhe të vihet lehtësisht?

E dyta, a ka ndodhur ndonjëherë që numri i byzylykëve elektronikë të jetë më i vogël se sa numri i masave të dhëna për mbikëqyrje elektronike?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Gjonaj!

Etilda Gjonaj – Për pyetjen e parë doja t'ia lija fjalën drejtorit, sepse ka të bëjë me shumë specifikime teknike, që në fakt i përkasin Drejtorisë së Mbikëqyrjes Elektronike.

Sa i përket pyetjes së dytë, nëse ka më pak pajisje se sa jepen vendime gjyqësore me masa për mbikëqyrjen elektronike, nuk mund të them se ka më pak pajisje, sepse edhe nga vlerësimi që është bërë në tërësi, sikundër e thashë, numri maksimal që ka pasur për të mbikëqyrur Drejtoria e Mbikëqyrjes Elektronike ka qenë nëntëdhjetë e një.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka pasur raste të tjera.

Pra, ky ka qenë maksimumi në këtë periudhë: nëntëdhjetë e një. Prandaj, edhe kur është bërë vlerësimi për treqind pajisje, ka pasur një konsideratë për numrin e vendimeve që mund të jepen për masat me mbikëqyrje elektronike.

Ermonela Felaj – Dua t’u kujtoj kolegëve, që kur është miratuar ligji “Për mbikëqyrjen elektronike” është parashikuar që fillimisht të zbatohet për vendimet që jepen nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë dhe nga Gjykata e Apelit, Tiranë. Pra, presupozohet që mbikëqyrja elektronike do të fillonte nga Tirana. Me sa kuptohet, edhe në Tiranë ka probleme, se nuk është arritur të realizohet ajo, për të cilën druheshim që s’do të ndodhte. Kujtoj se në vitin 2011, kur është miratuar ligji, ne kemi qenë në opozitë, flas për pjesën tonë, që jemi maxhorancë sot, dhe në fakt nuk kemi qenë pro miratimit të këtij ligji pikërisht për shkak të problemeve që mendonim se do të lindnin, probleme që në fakt konstatohet se kanë lindur, ndërkohë që ligji s’ia ka dalë mbanë t’ia mbërrijë qëllimit të tij.

Kujtoj se edhe arsyeja përse kërkesat janë të limituara, numri i byzylykëve që kërkohet të prodhohen është i limituar, gjë që vjen edhe për shkak se ligji është parashikuar të zbatohet për dënimet penale që jepen nga gjykata në Tiranë, jo në rrethe të tjera të Shqipërisë.

Po të kishte ecur, mbase do të ishte rasti të bënim një diskutim tjetër me ministren, për ta shtrirë edhe në qytete të tjera të Shqipërisë. Sigurisht, edhe po të shohim se si kanë ecur vendet e tjera përreth nesh, tendenca është që gjithnjë e më shumë po i referohen mbikëqyrjes elektronike, si një masë e cila siguron edhe zbatimin efektiv të vendimit të dënimit, por edhe si një masë që rrit sigurinë publike.

Zonja Gjebrea. Pastaj zonja Dhima.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre!

Në fakt, për mua ky është tamam një nga ato rastet që studentët e drejtësisë duhet t’i trajtojnë si tema, për të vërejtur se sa dukshëm dështon një ligj, sa dukshëm dështojnë të gjitha hallkat, sa dukshëm gjendet sistemi i drejtësisë në këtë situatë, dhe si mund të ndikojë kjo në lidhje me funksionimin e sistemit penitenciar, që u përmend edhe nga zonja ministre.

Tani situata është kjo. Sipas meje është situatë skandaloze. Si ka mundësi të gjendemi në këtë situatë dhe asnjë person nuk është i dënuar në lidhje me gjithë këtë gjë?

Pyetja ime ka të bëjë me situatën aktuale. A kemi ndonjë plan masash? Sepse, në qoftë se ne do të mbetemi peng i zinxhirit që ka përgjegjësi, mund të gjendemi përsëri në një situatë, përballë se cilës s’kemi çfarë të bëjmë, ndërkohë që kemi mbipopullim të burgjeve, si dhe mosfunksionim të këtij ligji apo të zinxhirit elektronik. Çfarë është kjo gjë që nuk mund të rregullohet, kur tashmë po flasim për teknologji të nivelit të lartë, ndërkohë që jemi përballë kësaj situatë dhe rrimë e shohim? Në fakt, mua më duket skandaloze që nuk mund ta zgjidhim dot. Nëse duhet, në këtë situatë edhe parlamenti mund të marrë përsipër diçka, dhe personat përgjegjës apo ata që merren me ligjet të mund ta rregullojnë këtë gjë.

Nga ana tjetër, sa është kostoja që i takon një personi, për të funksionuar zinxhiri elektronik? A kemi parashikuar diçka në buxhetin aktual, në lidhje me këtë situatë? Po supozojmë se edhe autoriteti përgjegjës financiar në Ministrinë e Financave do të dalë me disa konkluzione, por në fund të ditës fakti që gjykata dhe prokuroria kanë dhënë këtë përgjigje, në njëfarë mënyre na i ka lidhur duart. Çfarë masash kemi parashikuar? Sepse nuk besoj se thjesht do të rrimë e të presim vitin 2021, me shpresën se do të mbyllet kontrata.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Po zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj – E para, nuk mund të them se gjykata apo prokuroria i ka mbyllur dyert. Ka pasur një objekt hetimi. Sot, kur diskutohet dhe me hetimin e brendshëm administrativ, edhe me auditin e brendshëm, edhe me inspektimin financiar, fusha është më e gjerë dhe më specifike, duke evidentuar më saktë se kush janë përgjegjësit. Prandaj janë ndjekur të gjitha hallkat ligjore, me qëllim që këto dosje, kur të shkojnë në prokurori, të mos kenë mundësi të rrëzohen. Duke pasur në konsideratë këtë, nuk mund të them se ky proces ka dështuar. Përkundrazi, është një ndër proceset më të rëndësishme që ka ndjekur Ministria e Drejtësisë, së bashku me Ministrinë e Financave.

Ashtu siç e thashë pak më herë, unë pres raportin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elona Gjebrea – E kisha fjalën për dështimin sa i përket pajisjes me zinxhirë elektronikë, sipas kontratës. Në këtë rast themi se nuk funksionon, apo jo? Për këtë e kisha fjalën, jo për dështim të strukturave tuaja apo të punës suaj. E kam fjalën këtu: për sa kohë një kontratë nuk është funksionale, dhe ne kemi gjithë këto vështirësi, ky quhet dështim. Kështu e kuptoj unë.

Ermonela Felaj – Mund të vazhdoni.

Etilda Gjonaj – Zonja Gjebrea, absolutisht që e kuptoj dhe e mirëkuptoj pyetjen tuaj, sepse në të njëjtin përfundim kemi arritur edhe ne si Ministri e Drejtësisë, por thjesht po ju shpjegoj hallkat në mënyrë të vazhdueshme, për të kuptuar që në fund, mendoj, do të dalin përgjegjësit e kësaj situatë. Por kjo është një gjë. Ne na intereson pjesa tjetër, për ta përmirësuar shërbimin, që të mos jemi para situatës, kur duhet t’u drejtohem gjykatave dhe prokurorive, që as të mos kërkojmë e as të japin vendime me masa për mbikëqyrjen elektronike.

Për sa i përket faktit që ta konsiderojmë si një ligj, i cili nuk ka funksionuar, unë jam absolutisht pro, duke e parë sistemin në gjithë zinxhirin e tij, që mbikëqyrja elektronike duhet të jetë një shërbim që ofrohet. Nuk mund të themi se ligji po zbatohet keq apo se mund të dështojë apo ka dështuar, për shkak të problematikave të një kontrate, të cilën paraardhësit e

mi e kanë bërë, së bashku me strukturat e tyre, me qëllime të tjera dhe jo me qëllimin, siç tha edhe zoti Braho, për të ruajtur e ofruar këtë shërbim alternativ, i cili e lehtëson jashtëzakonisht shumë sistemin penitenciar.

Ashtu sikundër e përmendët edhe ju, zonja kryetare, që në fillim mendohej që ligji të shtrihej në Tiranë. Pastaj, me një vendim të Këshillit të Ministrave, në 2014-ën, ai u shtri në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Prandaj sot vështirësia jonë është më e madhe, nga shkaku se nuk i kemi të lokalizuar vetëm në Tiranë personat të cilëve u është u dhënë një vendim për masë me mbikëqyrje elektronike, por janë në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Së bashku me Policinë e Shtetit, jemi munduar t'i kemi nën mbikëqyrje dhe nën kontroll dyfish, duke përdorur akoma më shumë burime njerëzore, që të mos kemi pasoja të dëmshme.

Paulin Sterkaj – Mund të bëj një pyetje?

Ermonela Felaj – Po, zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj – Përshëndetje, zonja Ministre!

Unë si deputet, ashtu si dhe kolegja ime, jam i shqetësuar që ligji të funksionojë. Ne nuk na intereson fare kush shkon në prokurori apo në çfarë pozicioni janë ata që kanë bërë kontratën. Ne na intereson të dimë që nga ana juaj, si staf i Ministrisë së Drejtësisë, do të funksionojë apo nuk do të funksionojë? Sa për qind funksionon sot ky ligj dhe ato pajisje që janë marrë? Të mos shkojmë aty ku tha zoti Braho, Baba Taku, siç i thonë ata të LSI-së, që janë marrë për bagëti, për dhi kryesisht, e jo për njerëz. Këtë duam të dimë ne. Mënyra se si ndiqet çështja penale, për të çuar ndokënd para përgjegjësisë, është detyrë e juaja si ministri, jo e jona si deputetë. A do të funksionojë apo jo si ligj dhe si pajisje? Kaq Kisha.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sterkaj!

Po, zonja Ministre!

Etilda Gjona – Ne po i marrim të gjitha masat, duke përfshirë, sikundër thashë, edhe punonjësit e AKSH-it, të firmës, të kompanisë, të Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit të Provës, së bashku me strukturat e veta për mbikëqyrjen elektronike. Kjo me qëllim që të gjejmë një zgjidhje definitive, ose për të marrë disa pajisje të tjera, që vetë kompania t'i zëvendësojë, ose për të përmirësuar këto pajisje që kanë ardhur, të cilat, nëse pas kolaudimit nuk rezultojnë të jenë sipas parametrave të kontratës, atëherë do të gjejmë një mundësi tjetër.

Për mua do të ishte e kollajtë që sot të thosha atë gjë që kanë bërë paraardhësit e mi, duke i hedhur në kosh pajisjet e mëparshme: po, ky sistem nuk bën. Në kam detyrim ligjor të zbatoj ligjin “Për mbikëqyrjen elektronike”. Hajt të bëjmë një procedurë të re prokurimi publik, marrim ca pajisje të tjera e kështu me radhë.

Por kjo do të ishte jashtëzakonisht e dëmshme si për buxhetin e shtetit ashtu edhe për taksat e shqiptarëve, që ne të investojmë përsëri në një sistem të tillë, ku taksat e shqiptarëve janë përdorur për një gjë të tillë edhe para dy vjetësh. Kjo është arsyeja pse gjatë gjithë kësaj periudhe kohe, ne po mundohemi që brenda këtyre kushteve të bëjmë ca përmirësime: nga njëra anë të mos harxhojmë më shumë para nga ato të taksapaguesve, dhe nga ana tjetër të mund ta kemi këtë shërbim ashtu siç e parashikon ligji.

Them se deri në fund të muajit dhjetor, së bashku me të gjithë grupin e punës, do të mund të gjejmë një zgjidhje, të paktën për këtë numër të kufizuar personash, të cilët i kemi nën mbikëqyrje elektronike, si dhe për konsideruar më pas se si do të vazhdojë viti 2019, në lidhje me ofrimin këtij shërbimi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, për prezantimin, zonja Ministre!

Në fjalën tuaj, ju theksuar se jeni duke rishikuar ligjin nr. 10494, datë 22, 12. 2011 për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjykatë.

Sipas mendimit tuaj, ju do të kërkonit shfuqizimin e këtij ligji apo ndryshimet ën disa nene të caktuara të këtij ligji?

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Jo, jo, absolutisht!

Unë mendoj se sa më shumë dënime alternative të kemi për persona, të cilët marrim masa sigurimi nga gjykata ose marrin dënime, kjo do t'i shërbente më shumë edhe sistemit penitenciar që kemi sot, edhe shoqërisë, për të bërë rehabilitimin e tyre dhe jo thjesht ndëshkimin me burg.

Ajo çfarë ne po shikojmë te ligji “Për mbikëqyrjen elektronik”, është pikërisht harmonizimi me ndryshimet që do t'i bëjmë paketës, duke përfshirë ligjin për shërbimin e provës, si një ligj i ri, duke qenë në atë kohë edhe pjesë e paketës së reformës në drejtësi, ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe legjislacionin e sistemit penitenciar, gjithmonë duke i parë në harmonizim me ligjet kryesore, të cilat do të pësojnë ndryshime, me qëllim përmirësimin, bërjen sa më të efektshme, shkurtimin e afateve dhe pasjen e një kontrolli më të mirë. Në mënyrë absolute, që nuk do të kërkohej shfuqizimi i ligjit.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zoti Harusha, kishit ndonjë ndërhyrje?

Luan Harusha – Faleminderit, kryetare!

E nderuara Ministre, kisha një pyetje: ky tenderi prej 233 milionësh është vetëm për pajisjet elektronike, apo gjithashtu edhe për shërbimin, vëzhgimin e personave? Sa për qind e kësaj kontrate është zbatuar deri tashti?

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Nëse më lejoni, zonja kryetare, në lidhje me këtë pyetje mund të përgjigjet drejtori i Përgjithshëm, meqenëse ka të bëjë me çështje më teknike. Megjithatë, në parim, ashtu siç thashë, është realizuar 64 % e kontratës deri në fund të shtatorit. Kjo kontratë përfshin vetëm shërbimin e mirëmbajtjes dhe pajisjet, ndërsa pjesa e monitorimit është diçka krejtësisht tjetër.

Luan Harusha – Më falni! Pra, ju mendoni se kjo kompani do ta vazhdojë, do ta përmirësojë shërbimin? Sepse deri tashti nuk funksionon. Ju mendoni se do të vazhdojë ta bëjë këtë shërbim në të ardhmen? Do ta përmirësojnë shërbimin?

Etilda Gjonaj – Në varësi të rezultateve të grupit të punës, pasi t’i kemi kryer gjitha këto procedura që unë përmenda, pra të kemi dalë me rezultatet finale të inspektimit financiar, do të arrijmë të kuptojmë se çfarë do të bëjmë edhe me kontratën me kompaninë. Qëllimi ynë është të mos harxhojmë as një lek më shumë nga çfarë është harxhuar për këtë shërbim, por nga ana tjetër edhe shërbimi të jetë funksional. Kjo ka qenë e gjithë çështja, për të cilën ne jemi investuar jashtëzakonisht shumë si në kohë, si në burime njerëzore, po ashtu edhe me ekspertizë nga jashtë, që të arrijmë t’i realizojmë të dyja këto në mënyrë paralele.

Ermonela Felaj – në fakt u bënë dy pyetje për ju. Në qoftë se ka të dhëna sensitive nga ato të cilat ligji na detyron të mos i ndajmë me publikun, ju lutem të na e vini në dukje, dhe në atë moment, unë së bashku me anëtarët e komisionit detyrohem t’i largojmë kamerat. Aty ku duhet kjo masë, ju lutemi të na e thoni.

Sidoqoftë, fjala është për ju.

Engjëll Hysi – Fillimisht, më lejoni t’ju falënderoj, sepse jeni i vetmi komision, që na ka bërë një vizitë pune në Shërbimin e Provës, ndërsa sot na thërrisni në një debat, i cili lidhet më shumë me Shërbimin e Provës.

E kuptoj vëmendjen tuaj, sepse në një pjesë të madhe puna jonë ka të bëjë me sigurinë kombëtare, meqë ne ekzekutojmë vendimet e gjykatave dhe urdhrat e prokurorit, të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e me personat e dënuar.

Në aspektin teknik mbikëqyrja elektronike ka sallën operative, ku kemi njerëzit tanë të punësuar, ka të bëjë me byzylykun, që është pajisja personale e gjurmimit, që vendoset në

trupin e personit, ka të bëjë me firmën që bën kontrollin, nëpërmjet vëzhgimit satelitor, me firmat shqiptare me të cilat bën kontratat.

Parë në këtë këndvështrim, probabiliteti është se mund të ndodhë të ketë shpëputje sinjali, mund të ketë defekte të tjera, mund të ketë probleme që na lindin me byzylykun, me pajisjen që i vendoset qytetarit në këmbë, si dhe salla operative, e cila është një sallë që funksionin 24 orë. Nga kjo pikëpamje, për t'u kthyer te pyetja, mbikëqyrja elektronike ka pjesën e vet teknike, mekanike, si të themi, njëra që është vlera financiare, ndërsa tjetra është shërbimi që ata na ofrojnë.

Deri tani efektet janë te pjesa e parë, që ka të bëjë me pajisjet e gjurmimit. Këtu na kanë lindur problemet, këtu jemi edhe në debat me firmën. Jo thjesht pse zonja ministre është prezente, por e ka pasur shqetësim këtë. Ka dy urdhra të ministres, janë ngritur dy grupe pune, kemi kryer një sërë takimesh me firmën, me idenë e përmirësimit të sistemit. Kemi vështirësi, sepse ka momente që dalim jashtë specifikimeve teknike që janë vendosur në momentin kur është hartuar kontrata.

Për shembull, ne kërkojmë që byzylyku të ketë brenda një fije optike, gjë të cilën ato që kemi në përdorim nuk e kanë. Ka edhe kërkesa të tjera, për të cilat forma thotë se dalim jashtë kontratës.

Shpresojmë se në një takim të ardhëm, ku do të jetë prezent edhe AKSH-i, sepse në momentin e lidhjes së kontratës AKSH-i ka qenë prezent në pjesën e softit, meqenëse ne nuk jemi specialistë për këtë punë, mendojmë se do ta gjejmë një zgjidhje, duke e vënë firmën para përgjegjësisë, që të sjellë një pajisje, një byzylyk të ri, gjithnjë brenda vlerës financiare që ajo ka marrë. Pra, nuk bëhet fjalë për të shtuar shpenzimet tona.

Në lidhje që bëri pak më parë zoti Xhindi, nëse ekziston mundësia teknike që firma t'ia vendosë byzylykun në një pozicion prej nga ku ai mund ta heqë, byzylyku është si një orë, të cilën mund ta shtrëngojmë sa të duam. Në momentin që fiksohet, presupozohet të mos jetë më i hapshëm apo i këputshëm. Në këtë pikë sinjali vjen tek ne.

Në momentin ë vendoset byzylyku, ne kemi edhe një përfaqësues të shërbimit të provës. Për shembull, në rast se vendos zyra e Tropojës, do të jetë tekniku i firmës dhe punonjësi i shërbimit tonë në Tropojë, ata që shkojnë në banesë dhe ia vendosin byzylykun. Për çdo problem teknik që na lind, komunikojnë me sallën operative të policisë, komunikojnë dhe me firmën kontraktuese.

Dua t'ju bëj me dije se ligji është i mbështetur në një udhëzim të përbashkët të ministrit të Brendshëm, ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, sepse mbikëqyrja elektronike është komplekse, nuk është thjesht vendosim një rrip dhe e bëjmë gjumin rahat.

Problemi është që në momentet kur ne kemi sinjale, ne nuk kemi mundësinë njerëzore t'i verifikojmë. Në këtë rast ne komunikojmë me sallën operative të policisë në Shkodër, në Tropojë, në Gjirokastrë e ku të jetë. Më pas verifikimin e bën salla operative e policisë, e cila komunikon me sallën tonë.

Këto janë komunikime të vazhdueshme, në dinamikë. Shpeshherë janë konstatuar probleme serioze në momentin që kanë vajtur punonjësit e policisë dhe kanë bërë verifikimin e sinjalit.

Në aspektin teknik, i gjithë debati i sotëm ka të bëjë me faktin se, nga pikëpamja teknike, byzylyku ka probleme. Duke filluar nga korriku i vitit 2017 e deri më sot, me urdhër të ministrit të asaj kohe është ndërprerë marrja e urdhrit të ekzekutimit, sepse te marrëveshja, te udhëzimi i përbashkët, në pikën 2 parashikohet që gjykatat nuk mund të japin vendime pa marrë paraprakisht informacione nëse Shërbimi i Provës ka apo s'ka kapacitete për të ekzekutuar vendimin. Pra, kjo është parashikuar në udhëzim.

Në mënyrë periodike, ne i informojmë gjykatat, që për vështirësi dhe probleme teknike nuk mund të ekzekutojmë vendime të tilla.

Ermonela Felaj – Faleminderit për shpjegimet, zoti Hysi!

Unë do të doja të ftoja prokurorin e ekzekutimit të dënimeve penale në prokurorinë e Tiranës, zotin Berberi, për të na shprehur edhe ai pikëpamjen e vet, ose në fakt këndvështrimin që ka prokuroria lidhur me problematikat që ka paraqitur zbatimi i ligjit “për mbikëqyrjen elektronike”, që s’dua ta paragjykoj, por mund të jenë problematika që lindin nga vetë ligji, sikundër u tha qartësisht këtu, që janë problematika që kanë lindur edhe nga mënyra se si është kërkuar të vihet ligji në zbatim.

Kasem Berberi – Faleminderit, zonja kryetare!

Ju falënderoj për ftesën!

Ishte e nevojshme edhe për ne, që të jepnim mendimet tona në lidhje me funksionimin dhe zbatimin e dispozitave të ligjit “Për mbikëqyrjen elektronike”.

Sigurisht, këtu u evidentua qartë nga zonja ministre dhe nga Drejtori i Shërbimit të Provës, se ka një periudhë të gjatë kohe, rreth një vit e gjysmë, që në Tiranë, por edhe në rrethet e tjera besoj, nuk aplikohet zbatimi i mbikëqyrjes elektronike. Kjo për shkak të problemeve të pajisjeve teknike që sigurojnë funksionimin e mbikëqyrjes elektronike.

Në këtë kuadër, aktualisht problemet janë zero, sepse nuk kemi raste të aplikimit dhe të zbatimit të mbikëqyrjes elektronike. Kemi vetëm disa raste të hershme, para dy-tre vjetëve. Në Tiranë mund të jenë shumë pak raste. Që nga mesi i vitit të kaluar dhe deri tani ne si prokurori nuk kërkojmë aplikimin e mbikëqyrjes elektronike, qoftë për masat e sigurimit, qoftë

edhe për efekt të zbatimit të nenit 59 “Pezullimi i ekzekutimit të dënimit” ose qëndrimi në shtëpi. Pra, ka një boshllëk të madh që lidhet me mungesën e zbatimit të këtij ligji, kjo për shkak se nuk kanë lindur probleme në praktikë.

Në kuadër të bashkëpunimit që kemi me Shërbimin e Provës për problemet e tjera, gjithmonë e kemi pasur dhe kemi ngritur shqetësimin se si mund të gjendet rruga teknike për të filluar funksionimi i ligjit të mbikëqyrjes elektronike. E kemi vlerësuar, ashtu siç u raportua edhe këtu, se është një ligj shumë i rëndësishëm. Duhet të zgjidhet ky ngërç, sepse është shumë e rëndësishme që të gjejnë zbatim kërkesat e këtij ligji. Kjo u përmend nga të gjithë dhe nuk dua ta theksoj edhe unë.

Pra, është shumë e nevojshme që ky ngërç të zgjidhet dhe të fillojë zbatimi i dispozitave të këtij ligji.

Së bashku me kolegët, të paktën me këtë eksperiencë shumë të paktë për shkak se nuk është zbatuar, kemi mendimin se në tërësinë e tij ligji nuk ka probleme thelbësore. A ka nevojë për rregullime? Sigurisht që mund të ketë nevojë për rregullime ligjore, por problemi i vetëm ka të bëjë me pajisjet teknike të këtij ligji.

Pra, po zgjidhen problemet e funksionimit të ligjit, besoj se nuk ka probleme të mëdha. Në kuadër të reformës do të bëhen ndryshime.

Pra, unë gjykoj që iniciativa juaj për të thirrur Ministrinë e Drejtësisë dhe bashkë me ta edhe ne, është një nxitje për të gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë të problemit të funksionimit të këtyre pajisjeve. Pra, po ta gjykosim, zbatimi i këtij ligji, që ka hyrë në fuqi në vitin 2011 apo 2012, ka gjetur një hapësirë shumë të vogël. Shto këtu problemet që lidhen me pajisjet, funksionimi i këtij ligji është pothuajse shumë i pakët. Në këndvështrimin tim dhe të funksionit që kam, duke pasur parasysh edhe gjithë problematikën tjetër që lidhet me mbingarkesën e burgjeve dhe problemet e tjera, e shikoj shumë të nevojshme ndërhyrjen tuaj për t’i dhënë një zgjidhje sa më të shpejtë kapërcimit të këtij ngërçi. Mbase është e nevojshme që të kalojë momenti i parë, sepse sa filloi hapi i parë për zbatimin e këtij ligji u krijua problemi dhe nuk kemi çfarë të bëjmë.

Ermonela Felaj – Megjithatë, zoti Berberi, nëse mundem, në gjykimin tuaj, a duhet që mbikëqyrja elektronike të parashikohet, sepse besoj që nuk jemi akoma vonë dhe kemi plot shembuj për të marrë? Në Kodin e Procedurës Penale ne kemi një ligj të veçantë për mbikëqyrjen elektronike dhe i kemi të parashikuara shprehimisht rastet në të cilat mund të përdoret mbikëqyrja elektronike, që gjithsesi, me përjashtim të urdhrave të mbrojtjes, aplikohet vetëm në rast se personi ndaj të cilit do të vendoset kjo masë është dakord që të mbajë në trupin e tij një ...

Kasëm Berberi – Ka një përjashtim.

Ermonela Felaj – Përjashtimi lidhet me urdhrat e mbrojtjes.

Në fakt, a ka ardhur momenti, duke ditur që edhe vende të tjera rreth nesh kanë pasur probleme që në momentin e parë, probleme nga ato që kanë mbërritur deri në skandale për faktin se si janë përdorur të hollat dhe çfarë produkti është ofruar në vijim, që në këtë masë t'i japim fuqinë e duhur dhe ta përdorim atje ku duhet, ta shikojmë si një moment që duhet ta fusim edhe në Kodin e Procedurës Penale dhe jo të mjaftohemi thjesht me një ligj ...?

Kasëm Berberi – Duke u nxitur nga kjo që ju thatë, zonja kryetare, besoj se është e domosdoshme që ky ligj të implementohet në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Pikërisht atyre u referohet. A është i nevojshëm një ligj? Po, sepse do të zgjidhë problemet e tjera. Për mendimin tim, Kodi i Procedurës Penale duhet të pasqyrojë këto parashikime të ligjit, si dhe dispozita të tjera. Pra, unë mendoj se është e nevojshme të bëhen këto parashikime në Kodin e Procedurës Penale. Kjo do të ishte pozitive për të funksionuar më mirë dhe më drejt zbatimi i detyrimeve që burojnë nga ky ligj. Krijohet një diferencë ... Është e nevojshme të gjenden rregullime ligjore aty ku janë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Ermonela Felaj – Faleminderit për opinionin tuaj!

Zoti Sinaj, fjala është për ju.

Vullnet Sinaj – Pyetjes që unë doja të bëja iu dha përgjigje. E kuptoj shqetësimin që ka ministria dhe Shërbimi i Provës për pjesën e mbikëqyrjes elektronike, por doja të dija, a jeni në gjendje ta zgjidhni vetë këtë problem apo po kërkon ndihmën tonë dhe si e kërkon ndihmën tonë si Komision i Sigurisë dhe si parlament? Si mund t'ju ndihmojmë konkretisht? Nëse ju e zgjidhni vetë, atëherë na thoni si do ta zgjidhni këtë problem, në të kundërt na thoni çfarë duhet të bëjmë konkretisht ne si Komision i Sigurisë që t'i propozojmë parlamentit një zgjidhje për këtë problem.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sinaj për pyetjen!

Po, zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj – Ju falenderoj, zoti Sinaj, për mbështetjen! Një falenderim të veçantë kam për kryetaren, e cila ka kërkuar disa herë ta sjellë në vëmendje këtë çështje!

Duke përfunduar të gjitha proceset që kemi pasur këtë periudhë dhe duke bashkëpunuar me kompaninë (nuk ka gjë të pazgjidhshme, thjesht kemi tentuar të zgjidhim një gjë pa pasur dëme si financiare ashtu edhe në shërbime), shikojmë që në shërbim po cedojmë për shkak se kemi bërë kërkesat për gjykatat dhe prokuroritë. Mendojmë se do të arrijmë në një zgjidhje me bashkimin e kompanive që ofrojnë këtë shërbim, që, ashtu siç edhe drejtori e

tha, ose të na sjellin pajisje të reja, të zëvendësojnë pajisjet e vjetra me të reja, pavarësisht se nuk i kanë specifikimet teknike, duke bërë një shtesë në kontratë, me qëllim që të kemi pajisje të reja apo të thuhet që këto pajisje përfundimisht që janë kolauduar dhe nuk kanë asnjë lloj defekti dhe jemi në rregull me procesin.

Roli i parlamentit dhe i komisionit është shumë i rëndësishëm, prandaj për ne do të ishte ndihmë gjithçka që ju mendoni se do t'i shërbejë këtij procesi. Në çdo rast unë do t'ju bëj me dije sapo përfundimet e këtyre inspektimeve financiare të mbarojnë, rezultatet që do të kemi dhe, nga ana tjetër, si do të konkludojmë me zgjidhjen që do t'i japim kompanisë për ofrimin e shërbimit. Në një moment të dytë shikojmë për të pasur një ndihmë konkrete nga komisioni nëse nuk ka diçka të tillë paraprakisht që edhe ju e mendoni. Çdolloj ndihmë nga ana juaj për pjesën e këtij shërbimi do të ishte pa diskutim një vlerë e shtuar e të gjithë procesit që ne kemi ndjekur deri tani.

Vullnet Sinaj – Ndihma ... Nëse ju keni hyrë në bisedime me firmat që mbulojnë këtë dhe ato ju kanë garantuar që me një shtesë kontrate brenda kostove që kanë qenë do t'ju zgjidhin problemin, atëherë është në rregull, por në rast se ju nuk keni arritur një dakordësi me firmën që ka marrë përsipër mbikëqyrjen elektronike, jeni ju që duhet të na kërkonin ndihmë.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Sinaj për pyetjen dhe për faktin që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po zoti Hysi, do t'ju lejoj këtë ndërhyrje.

Ëngjell Hysi – Ju faleminderit!

Për sa i përket pyetjes së zotit Sinaj, ne kërkojmë ndihmën tuaj që në Kodin e Procedurës të parashikohen masat e sigurisë me mbikëqyrje elektronike. E kemi kërkuar dhe nuk janë futur. E kanë lënë për arrest shtëpie, ndërkohë, ligji e parashikon edhe në rastet kur ka urdhër mbrojtjeje për dhunë në familje apo edhe raste të tjera. Nëse kjo do të parashikohet në Kodin e Procedurës është akoma më mirë, sepse është ligji bazë.

Ne kemi hyrë në negociata me firmën, duhen bërë disa shtesa në kontratë, sepse në çdo rast na quhet shkelje e karakterit ligjor, dhe jemi besimplotë që bashkë me firmën do të sjellim pajisje të reja dhe shumë shpejt do të bëjmë të mundur që gjykatat të kenë të gjithë hapësirën të japin vendime penale për masën e sigurisë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Hysi!

Në fakt, sikundër po thosha, pyetja e zotit Sinaj na ndihmon edhe për të shprehur diçka tjetër. Ne nuk e thirrëm këtë seancë dëgjimore për interesin formal të të kuptuarit se si është zbatuar një ligj. Jo thjesht dhe vetëm për të vënë në fokus një çështje, por për të nxitur

përgjegjësitë e veprimit ndaj një situate që, në fakt, është e papranueshme, sepse janë miliona lekë të dhëna nga buxheti i shtetit dhe përfundimi është që një teknologji që ne kërkojmë ta përdorim gjatë ekzekutimit të vendimeve që përmbajnë dënime penale, në fakt, nuk po arrijmë ta përdorim.

Pa dashur të hyj në detaje të çështjes, nga parashtresa që bëri zonja ministre dhe nga përgjigjet e pyetjeve që u bënë këtu mendoj se në thelbin e vet çështja është e qartë. Unë kërkoj që investigimi juaj apo i organeve të tjera që janë pjesë e institucioneve të tjera qendrore, të mos shikonte përgjegjësinë në nëpunës të një niveli të ulët, pavarësisht se sekretarët e përgjithshëm nuk janë të tillë, por janë nëpunës të nivelit të lartë, sepse nuk mendoj kurrësi që përgjegjësia aty është e një personi të vetëm. Nëse bëhet fjalë për prokurime, e dimë të gjithë që përgjegjësia është sa e entin prokurues, e titullarit të entit prokurues, sa edhe e atij që ka nxjerrë urdhrin për këtë ent prokurues. Pra, përgjegjësia duhet të mbërrijë edhe në nivele politike.

Në fakt, nuk e di nëse ankimi juaj i është përmbajtur të njëjtut fakt që ka referuar ish-ministri teknik, që më duket shumë i mangët dhe se ka një selektivitet nga ana e tij për të përqendruar dhe goditur individë të caktuar, por jo për të nxjerrë përgjegjësi deri në fund në lidhje me këtë çështje. Kështu që, në këtë pikë unë besoj se kam mbështetjen e të gjithë anëtarëve të këtij komisioni që përgjegjësia duhet të shkojë deri në fund dhe nuk duhet të kursejë as ministra që kanë drejtuar Ministrinë e Drejtësisë në këtë kohë, sepse realisht është e papranueshme që sot hyjmë në vitin e pestë dhe në fakt, as në publik nuk janë përmendur që edhe ministra kanë përgjegjësi në këtë çështje.

Unë besoj se ky ishte interesi më i madh që patëm ne sot. Mendoj që në pikën ku kemi mbërritur ndoshta edhe ligji duhet të parashikojë ose duhet të pësojë ndryshime në vetvete, sepse kushtet që parashikon ligji për byzylykët elektronikë duhen përforcuar në mënyrë që të mos biem pre e teknikaliteteve që sjellin edhe dështime kontratash. Nuk e di nëse AKSHI është investuar në dy kontratat e mëparshme, por e shikoj me vend që AKSHI duhet të investohet. AKSHI është investuar për bërjen e kushteve dhe kriterëve teknike edhe për sisteme të tjera shumë më të rëndësishme, kështu që, patjetër që do të ishte e domosdoshme kjo pjesë.

Unë shpresoj që ne të jemi në kontakt të vazhdueshëm. Për sa i takon ndërhyrjes në ligj, unë gjykoj që, në vend që të operojmë me amnisti për të evituar mbipopullimin e burgjeve, ka ardhur momenti që ne të operojmë me ligj dhe të bëjmë parashikime të tipit që personave, të cilëve u ka ngelur një kohë shumë e shkurtër dënimi, 1 vit apo 2 vjet, duke pasur parasysh edhe veprën për të cilën ai është dënuar, t'i nxjerrim nga burgu dhe t'i vëmë në mbikëqyrje elektronike, por kjo duhet parashikuar me ligj. Edhe nëse mbikëqyrja elektronike do të

funksiononte siç duhet, kategoria e njerëzve që do të përfitonin nga kjo do të ishte e atyre ndaj të cilëve është vendosur arrest në shtëpi, detyrim qëndrimi, ndalimi për të dalë jashtë vendit, njerëzve ndaj të cilëve jepen alternativa të dënimit si gjysmë liria, pezullimi, qëndrimi në shtëpi apo ata që lirohen para kohe me kusht.

Ka ardhur momenti të bëjmë edhe ne të njëjtën gjë që po bën Italia, vendi nga i cili u mor ky ligj si model, që byzylykun elektronik po e përdorin jo thjesht ndaj individit që konsumon vepër penale, por në rastet e përndjekjes ose në raste të urdhrave të mbrojtjes, byzylyk elektronik mban edhe viktimë, kjo në mënyrë që organet e policisë të kenë mundësi që në kohe reale të ndërhyjnë dhe ta shpëtojnë atë nga pasojat e një vepre penale që vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e subjektit në fjalë.

Shpresojmë që të mund ta vijojmë këtë bashkëpunim dhe qëndrim përkundrejt njëri-tjetrit ashtu sikundër e kemi nisur. Ne jemi shumë të gatshëm që të japim të gjitha opsionet tona dhe natyrisht të sensibilizojmë që kjo çështje të dalë në dritë, që i gjithë zinxhiri i përgjegjësisë të zbulohet deri në fund dhe përgjegjësit të shkojnë para drejtësisë. Në pikën ku kemi mbërritur nuk mund të justifikohemi gjithmonë me faktin e vendimit të gjykatës apo vendimit të prokurorisë, ka shumë momente që unë besoj se duhen lëvizur.

Nga ana tjetër, mendoj se nuk duhet humbur më kohë në gjetjen e një rruge që bën të zbatueshme kontratën me ato mënyra që ju sugjeroni që të bëhen kushte shtesë në kontratë, që përmirësojnë cilësinë e byzylykëve elektronikë, por duke qëndruar brenda të njëjtave vlera financiare që janë akorduar që më herët.

Faleminderit për prezencën dhe rastin që patëm për të biseduar për këtë gjë! Ditë mbarë!

Faleminderit edhe kolegëve!

MBYLLET MBLEDHJA